



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 35-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 01. 12. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi anëtar
19. Lulzim Rrustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic anëtar
31. Xhavid Maholli anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
5. Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së
6. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-se
7. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
8. Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR
9. Imer Rustemi, Drejtor i DI
10. Avni Olluri, Drejtor i GJK
11. Faul Xhemajli, Drejtor i Administratës
12. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
13. Burim Rustemi, Shef i kabinetit
14. Elmi Bublica, Drejtor i NOU në Lipjan
15. Xhelal Krasniqi, Drejtor i NO"Pastrimi" në Lipjan
16. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
17. Kimete Jashanica, OSBE
18. Përfaqësues , "YHR"
19. Përfaqësues të OJQ "POLIS"
20. Përfaqësuesit e mediave
21. Bestar Ibrahim, Operator i teknologjis informative
22. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
23. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 28 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe unë kam një propozim për plotësimin e rendit të ditës me një pikë si vijon: Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kopshtit për fëmijët parashkollor në Lipjan.

Në vazhdim pyeta anëtarët e Kuvendit se a ka dikush vërejtje apo plotësime në rendin e ditës.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje apo plotësime në rendin e ditës, Kryesuesja të njëjtin e vuri në votim së bashku me propozimin për plotësim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht me 28 vota prezent të anëtarëve për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të të Kuvendit
2. Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve
3. Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Lipjanit
4. Informatë për shërbimet e ofruara të Kompanisë "Pastrimi"

5. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kopshtit për fëmijët parashkollor në Lipjan.

Para se të kalohet në shqyrtimin e pikave sipas rendit të ditës Kryesuesja propozoj që të kalojmë në pyetje dhe përgjegje duke pyetur se a ka dikush pyetje?

Florent Hoxha, unë para dy mbledhjeve të Kuvendit kam kërku të subvencionohen dy familje njëra ka qenë familja e Skender Gërbeshit dhe tjetra e Feim Nezirit nga Sllovija dhe nuk kam marrë kurrfarë përgjegjje lidhur me kërkesën time.

Çështje e dytë është se një pjesë e rrugës kah shtëpia e Luanit është asfaltu kurse nja 50 metra kanë mbetur pa u shtruar dhe kompania në këtë pjesë e ka shtruar me zhavor andaj pyes se a do të asfaltohet në këtë vit edhe ajo pjesë dhe si qështje tjetër është se anëtarët e Kuvendit kemi marr një ftesë me imell nga Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit ku kjo Drejtori ka pasur një agjendë të organizimit për 28 Nëntor. Ne më herët kemi pasur traditë që për 28 Nëntor të thërrasim akademi solemne meqë në këtë ditë është shpallja e ditës së Flamurit dhe Pavarsisë, dalja në skenë e UÇK-së dhe ditësindja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, andaj është e rrugës dhe e ndershme që edhe ekzekutivi edhe Kuvendi ta festojmë këtë ditë në mënyrë madhështore e jo vetëm me aktivitete sportive.

Linda Shahini, unë kam një propozim për ekzekutivin që të nxjerr një Vendim apo Rregullore për ndalimin e pijeve energjike dhe produkteve tjera që janë të dëmshme për shëndetin për moshat nën 18 vjeç.

Ramiz Qeriqi, unë po paraqesë shqetësimet e qytetarëve lidhur me asfaltimin e rrugës prapa ABES ku kjo rrugë është asfaltu natën dhe trashësia e saj diku-diku është vetëm 3 cintrimetra dhe për këtë kam folë mjaftë më herët por fjalët e mia kanë shkuar në vesh të shurdhët.

Pastaj tha se më herët kam bërë pyetje në Kuvend se si është bërë pranimi i rojeve në shkollën e mesme dhe nuk kam marrë kurrfarë përgjigjje. Për Grackë disa herë kam pyet pse nuk mbahet mësimi edhe në gjuhën shqipe dhe a është kjo shkollë në Republikën e Kosovës. Për klubin "Ulpiana" që ka pasur të hyjë në lojë por nuk është luajt ajo lojë por dikush ka thënë se për këtë udhëheqësija e klubit i ka fajet dhe e kanë shitur lojën. Për Drejtorin e shëndetësisë është folë nëpër media për keq menaxhim dhe për punë të kqija në shtëpinë e shëndetit e gjithashtu edhe për mos respektim të orarit të punës nga punëtorët të shtëpis së shëndetit dhe për të gjitha këto është mirë që na njoftoj Drejtori. Gjithashtu potencoj qështjen e 200 kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe pyes Drejtorin e Urbanizmit se kur do të shqyrtohen këto kërkesa. Kam edhe një qështje tjetër meqë këtu është folë se kompanive të pa përgjegjshme që u është dhënë prona te QMI-ja do t'i largojmë të gjitha por tani kjo qështje është harruar.

Lulzim Rrustemi. Kam pyetje edhe personalisht unë edhe grupi parlamentar i PDK-së se cili është projekti që po punohet në sheshin "Adem Jashari" meqë kam përshtypje se ky projekt nuk është profesional dhe nuk po punohet sipas projektit të mëhershëm.

Shqetësim tjetër është e studentëve të Lipjanit lidhur me Bibliotekën e Qytetit e cila punon vetëm deri në ora katër dhe është kërkesë e studentëve që kjo Bibliotekë të punaoj edhe të shtunave.

Festa e 28 Nëntorit këtë vit Komuna e Lipjanit ka dështu në festimin e kësaj feste, andaj në të ardhmen këtë festë duhet ta shënojmë si duhet.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, po i përgjigjem Lulit lidhur me punën e Bibliotekës se kjo qështje është shqyrtu në këshillin e drejtorëve dhe me Kryetarin dhe është marrë Vendim që Biblioteka e Qytetit të punoj me dy ndërrime.

Valbona Shillova, po e paraqes shqetësimin e qytetarëve të fshatit Topliqan lidhur me asfaltimin e 4 rrugëve në këtë fshat të cilat rrugë janë asfaltu aty ku kanë qenë simpatizantët e tyre e jo sipas nevojave të gjithë qytetarëve.

Hajrije Salihu, pyeti se mbjellja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit a është bërë konsultimi me ekspertët meqë te shkolla “Adem Gllavica” këta drunjë e kanë zënë rrugën.

Xhavid Maholli, rrugët e parapara në Gadime aty a do të përfundojnë në këtë vit apo jo.

Zoran Çirkoviq, tha se kam pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike ku qytetarët edhe shqiptar edhe serb në Lipjan nga një lagje që jetojnë 30 familje në rrugën Aleksander Stipqeviq për asfaltimin e kësaj rruge dhe përgjegjja e Drejtorit ka qenë që në gjysëmvjetorin e parë nuk do të mund të asfaltohet por në gjysëmvjetorin e dytë, gjithashtu është edhe një kërkesë e qytetarëve të fshatit Suhadoll për rrugën që lidh Komunën e Lipjanit me Komunën e Graçanicës, andaj pyetja është se a do të asfaltohen deri në fund të vitit këto rrugë?

Blerim Gashi, unë para dy muajve kam pyet se a do të rregullohen rreth rrotullimet dhe Kryetari pat thënë se është lidh kontrata me kompani dhe unë po e shoh se puna nuk ka fillu dhe shtrohet pyetja se a ka dështu ai tender apo qka është bërë. Pyetje tjetër kam lidhur me llugën 4 kursi “Hajredin Bajrami” e cila ka mbetur në gjysëm dhe si është puna këtu me kontraktorin a do të shkëputet kontrata apo do të vazhdoj puna.

Enver Kozhani, kam pyetje për Drejtorin e Inspektionit se a bëjnë kontrolla nëpër markete në fshatra se e dijë se ka artikuj që ju ka skadu afati dhe ende shiten në këto markete.

Nehat Tërpeza, qytetarët e lagjes Hoxha në Ribarë të Madh kanë parashtrur kërkesë për hapjen e një përocke e cila gjatë të reshurave del nga shtrati dhe pyes se a do të hapet apo jo kjo përockë meqë nuk kushton shtrenjt.

Imri Ahmeti, Kryetar kërkoj falje për vonesën në mbledhje dhe tha se do të përgjigjem në pyetjet që i mora.

Për drunjët dekorativ që i përmendi Hajrija po ju them se këta drunjë janë mbjellë me mbikëqyrjen e DEMOS-it dhe janë ekspert dhe është e vërtetë ajo se diku, diku janë ngushtu trotuarët por në të ardhmen këto trotuare do të zgjerohen nga brenda për një metër. Unë e dijë se diken e pengojnë trotuarët gjithashtu edhe parkimi por ne duhet ta shiqojmë të përgjithshmen dhe e përgjithshmja është mirë dhe Qyteti i Lipjanit ndoshta do të jetë qyteti më pastërt ekologjik.

Për Gadime që pyeti Xhavid projektet janë 2 vjeqar dhe nëse lejon koha do të kryhet pjesa e parë.

Për rrugët që pyeti Zorani do të shtrohen në vitin e ardhshëm.

Për rrethrrrotullimet që tha Blerimi se është lidh kontrata, unë kam thënë është shpallë tenderi jo është lidh kontrata.

Sa i përket rrugës 4 kursi ju them se nuk mund të implementohet projekti ekzistues meqë parashihet hjekja e objekteve dhe shpronësim i pronave dhe ne në bashkëpunim me OSHP-në duhet të shiqojmë ndryshimin e këtij projekti.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 34-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje apo plotësime, Kryesuesja të njejtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota, për

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali e mbledhjes së 34-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Ilir Tasholli, Drejtor i DPU, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata e duke lexuar të njëjtën.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, dëgjuam Drejtorin u tha se mbi 15 mijë objekte janë të ndërtuara pa leje dhe për legalizim janë paraqit vetëm 75 kërkesa, andaj si grup parlamentar i LDK-së pyes se sa prej këtyre kërkesave janë legalizuar objektet, posaqërisht objektet kolektive.

Edita Gashi, legalizimi i objekteve ka dështuar jo vetëm në Komunën tonë por edhe në komuna tjera në përjashtim të komunës së Prishtinës. Në vazhdim tha se në këtë informatë kam hasë në disa fjali që kundërshtohen në mes veti shembull thuhet janë paraqitë vetëm 75 kërkesa për legalizim kurse në anën tjetër kërkohet shtimi i numrit të stafit për legalizim të objekteve.

Florent Hoxha, është e vërtetë se na si anëtarë të Kuvendit kemi kërku që të njoftohemi lidhur me legalizimin e objekteve. Unë jam i bindur se këto 75 kërkesa që janë paraqitë për legalizim janë vetëm nga qyteti kurse nga fshatrat nuk është asnjë kërkesë. Unë mendoj se Ligji për legalizimin e objekteve nuk ka qenë i mirë dhe për këtë arsye nuk mund të zbatohet. Shembull po e marr për legalizim të një objekti të vjetër ka qenë shuma e madhe e mjeteve dhe për këtë qytetarët nuk kanë paraqitë kërkesë. Unë konsideroj se Ligji i ri për legalizim të objekteve do të jetë më i përshtatshëm dhe qytetarët do t'i legalizojnë objektet e tyre.

Ramiz Qeriqi, pyeti se DPU a ka informata se sa objekte janë të ndërtuara në pronën publike si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Blerim Gashi, kemi një proces që ka filluar ngadal dhe menjëherë është ndërpre për shkak të Ligjit i cili nuk ka qenë i përshtatshëm për kushtet dhe rrethanat që kemi, andaj shpresoj se Ligji i ri do t'i përshtatet kushteve dhe rrethanave që i kemi dhe se objektet që janë ndërtu më herët në fshatra duhet të trajtohen më ndryshe dhe duhet të lehtësohen procedurat.

Lulzim Rustemi, qështja e legalizimit të objekteve është me rëndësi nacionale dhe po shihet se në këtë proces kemi dështu për shkak të Ligjit që nuk ka qenë i përshtatshëm. E dyta është se dështimi i legalizimit të objekteve ka ndodh për shkak të mos informimit të qytetarëve dhe në këtë drejtim Komuna ka humbje. Besoj se pas aprovimit të Ligjit të ri ky proces do të realizohet.

Ilir Tasholli, sipas diskutimeve po del se legalizimi është një problem i cili si proces nuk ka ecë. Unë e kam një opinion se edhe Ligji i ri nuk do të ketë shumë lehtësime.

Te pyetja e Agronit se sa janë objekte individuale dhe sa kolektive këtë nuk e di.

Te pyetja e Editë Gashi që përmendi shtimin e stafit unë ju them se kjo parashihet edhe me Ligj dhe shtimi i stafit nuk parashihet vetëm për DPU por përfshihen edhe Bujqësia dhe Gjeodezia.

Te pyetja e Luanit se a ka ndërtime në pronat shoqërore këtë nuk e parasheh Ligji por i parasheh vetëm ndërtimet pa leje pa marr parasysh pronën.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesja propozoj që të kalohet në pikën e tretë.

III

Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Elmi Bublicës Menaxher i Njesisë Operative të Ujësjetës në Lipjan i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe pastaj përmes kinoprojektorit i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata e cila sajton pjesën përbërëse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, kjo informatë është e rëndësishme për neve dhe qytetarët dhe në bazë të kësaj informate pamë edhe përgjegjësitë dhe obligimet që janë si të njesisë së ujësjetës ashtu edhe qytetarëve.

Në fshatin Babush shumicën e kohës nuk kemi ujë, andaj kërkoj nga Drejtori të mirren masat më të ashpra meqë konsideroj se si shkak i mungesës së ujit janë edhe keqpërdorimi i ujit.

Pastaj tha se edhe ne që nuk kemi ujë ngarkohemi me faktura me shuma bukur të mëdhaja. Në vazhdim kërkoj nga Drejtori që të kontrollohen pusët që janë hapur nga Bektel Enka se a është uji i pijshëm.

Blerim Gashi, këtë qështje e kemi shtrur disa herë dhe se uji është qështje fundamentale edhe e zhvillimit ekonomik. Unë pyes se a ka mundësi që kjo njësi operative e ujësjetës të ndahet nga korporata e ujërave regjionale dhe të formohet kompani në vete.

U tha se vendet ku janë pusët gjinden në pronat që janë të privatizuara dhe kjo më shqetëson dhe pyes si ka pasur mundësi të privatizohen këto prona. Qështje tjetër dhe shqetësuese është bunaret që gjenden te Sitnica shpesh herë vërshohen nga ujërat e zeza. Unë kam informatë se Ribari i Vogël nuk furnizohet me ujë kurse fakturohen qytetarët. Në vazhdim përmendi edhe reduktimet e mëdha të ujit gjatë sezonës së verës në disa pjesë të qytetit.

Ali Stublla, gjatë stinës së verës objektet kolektive sidomos katet e larta nuk kanë ujë dhe nuk e pashë ndonjë plan për zgjidhjen e këtij problemi. Gjithashtu përmendi se fshati Grackë dhe Topliqan ende nuk kanë ujësjetës a jemi në shekullin 21. Në vazhdim foli lidhur me mbylljen e pusetave të kanalizimit sidomos te shtëpia e kulturës ku kanalizimi nuk është funksional.

Merita Zeqiri, u fol për pusetat dhe kanalizimet që nuk janë funksional e gjithashtu ka edhe vjedhje të kapakve të pusetave që këto puseta paraqesin rrezik për qytetar dhe një e tillë pa kapak është te Qerdhja e fëmijëve dhe propozoj që kësaj pusete t'i vëhet kapaki. Në fund pyeti se a janë zbulu keqpërdoruesit e ujit dhe a janë denu.

Agron Hajdini, furnizimi me ujë i qytetarëve bëhet nga ujërat nëntokësore dhe mua po më intereson se deri në cilën lartësi mund të furnizohen qytetarët në mënyrë që të hiqet dilema për blerjen e banesave ku shpesh herë thuhet se katet e larta nuk kanë ujë. Në fund pyeti se njësia e ujësjetës a ka ndonjë strategji për largimin nga furnizimi me ujë nga pusët banesat kolektive.

Lulzim Rrustemi, Lipjani është i furnizuar mirë me ujë, mirëpo është shqetësuese furnizimi me ujë nga pusët te Sitnica kur e dijmë dhe u tha se ajo pjesë vërshohet nga ujërat e zeza.

Nehat Tërpeza, kam kërkesë për Drejtorin që aty ku po ndërhyhet për riparimin e ujësjellësit po dëmtohen trotuaret dhe asfaltet, andaj kërkoj që këto dëmtime të riparohen menjëherë.

Florent Hoxha, na edhe në KPF kemi dhënë vërejtjet tona dhe kemi kërku nga Drejtori që qytetarët të furnizohem me ujë 24 orë pa ndërprerë dhe kualiteti të jetë sipas standardeve të parapara. Këtu më tepër shqetësimet u ngritën për zonën urbane por nuk duhet të harrojmë edhe fshatrat. Në disa fshatra që posedojnë ujësjellës dhe nuk menagjohen nga ujësjellësi janë fshatrat Shalë, Krojmir dhe Resinoc dhe ujë përdoret pa u kontrollu fare, andaj pyes se a është bërë ndonjë analizë e këtij uji. Në vazhdim kërkoj nga Drejtori që siguria e puseve për furnizim me ujë të jetë më e lartë. U tha se korporata e ujërave regjionale në bashkëpunim me donatorë ka një projekt për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit, andaj pyes se deri ku ka shkuar ky projekt.

Arben Bahtiri, kompania e ujësjellësit në Lipjan e di që ka probleme dhe për të gjitha këto probleme duhet të kyqet edhe Komuna. Në vazhdim kërkoj që njësia e ujësjellësit në Lipjan të ndahen nga korporate e ujërave regjionale. Në vazhdim kërkoj nga Drejtori që kur paraqiten defekte në ujësjellës të njoftohen paraprakisht qytetarët me që pas riparimit të defektit shtypja e ujit kur është e madhe dhe po shkaktohen dëme në prishjen e makinave të lamjes.

Burbuqe Fazliu, pyeti Drejtorin pse nuk furnizohet me ujë lagja Gërbeshi dhe Butrinti në Lipjan.

Elmi Biblica, në KPF kemi bisedu që Babushi të jetë në prioritet. Sa i përket puseve të Bektel Enkes nuk besoj se uji do të jetë i pijshëm me që të gjithë e dijmë se në Babush ka thengjill. Sa i përket ndarjes nga kompania e ujërave regjionale unë nuk besoj se ne e kemi mundësinë me u nda.

Për Ribarë të Vogël u tha se gjatë verës nuk furnizohen me ujë dhe unë po ju them se nëse në Ribarë kursohet uji sigurisht do të ketë ujë.

Na si njësi bëjmë vetëm zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe hapjen e puseve dhe ata nëse sigurohet vendi nga Komuna, por nuk bëjmë hulumtime për rezervat e ujit.

Te pusët që përmendi Merita ata kapak shkojnë me korniza dhe besoj se së shpejti do të rregullojmë. Në vazhdim foli lidhur me masat që ndërmirren për keqpërdoruesit e ujit.

Heset Sahiti, Drejtor i DSHP-së falënderoj Menaxherin e ujësjellësit për informatën që e paraqiti ku e pamë se qfarë gjendje e kemi ujësjellësin. Në vazhdim tha se aty ku ka rrjet të ujësjellësit në fshatra duhet t'i dorzohen në menaxhim njësisë së ujësjellësit dhe këtu kemi të bëjmë në fshatrat Shalë, Krojmir dhe Resinoc.

Sa i përket ujësjellësit për 21 fshatra, faza e parë ka fillu për 10 fshatra e në fazën e dytë do të përfshihen edhe fshatra tjera.

Për katër fshatra si që janë: Llugaxhi, Ruboc dhe Kojkë nuk janë kyq ende në ujësjellës edhe pse kanë premtu që të hyjnë në sistem.

Pas përfundimit të kësaj pike Kryesuesja dha pauzë deri në ora 14,⁰⁰

Pas pauzës në ora 14,30 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt

IV

Informatë për shërbimet e ofruara të Kompanisë “Pastrimi”

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Xhelal Krasniqi, Menaxher i Njesisë Operative “Pastrimi” në Lipjan i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit e pastaj përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Enver Kozhani, ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë informatë dhe kemi konstatu disa dobësi të kompanisë. Në lokalitetin tonë grumbullimi i mbeturinave bëhet në formë klasike me thasë dhe kemi raste kur kompania nuk vjen në ditët e caktuara që ka kështu që qenët endacak gjatë natës i shpërndajnë këto mbeturina. Në vazhdim kërkoi që mundësisht kompania t'i furnizon qytetarët me kontinjera plastik. Pastaj tha se po krijohen shumë deponi të egra. Në vazhdim përmendi mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të dimrit duke shtuar se hedhet shumë pak kryp.

Agron Hajdini, unë në emër të grupit parlamentar të LDK-së falenderojmë Drejtorin për paraqitjen e kësaj informate dhe i urojmë që kjo kompani edhe në të ardhme të vazhdoj me punën që është duke bërë.

Xhevat Olluri, Drejtori na njoftoi për punën dhe vështirësitë që kompania ka e gjithashtu edhe sipas informatës shihet se është një numër i vogël i qytetarëve që kanë bërë kontratë me kompani dhe kanë hy në sistem a ne të gjithë e dijmë se edhe ata që nuk kanë bërë kontratë krijojnë mbeturina dhe i hudhin dikun në deponi të egra. Në vazhdim propozoj që pagesa për mbeturina të bëhet përmes Komunës qoft me fakturë të tatimit në pronë apo ndonjë mënyrë tjetër e pastaj Komuna t'ia paguaj shërbimet kompanisë.

U përmend nga Enveri që mundësisht qytetarët të furnizohën me kontinjer dhe ju njoftoj se më heret e kemi pasur këtë formë por në një kontinjer 5-6 familje kanë hudhur mbeturina a ka paguar vetëm një kështu që jemi detyru me i hjek kontinjerët. Sa i përket pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit ju them se sivjet jemi më të përgatitur dhe kemi blerë sasi të mjaftueshme të kripës, por na kemi vetëm dy dhe është i pamundur të përfshihet i tërë tereni.

V

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kopshtit për fëmijët parashkollor në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Rasim Hasani, Drejtorit të DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, e përmendi Drejtori se ka qenë një vendim i mëparshëm për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qerdhës, andaj pyes pse me e nda këtë parcelë ku atë veq është Qerdhja.

Nehat Tërpeza, na si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E KOPSHTIT PËR FËMIJËT
PARASHKOLLOR NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e kopshtit për fëmijët parashkollor në Lipjan në parcelën kadastrale P-71409044-01788-0 në vendin e quajtur "Varosh" me sipërfaqe prej 2590 m² të evidentuar në Certifikatën Nr.5457/2016 ZK Lipjan P.Sh Qerdhja e Fëmijëve.

Neni 2

Kushtet urbanistike-teknike si pjesë e procesit të procedurës së implementimit të projektit që parashihen me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit do të definohen në harmoni me Projektin Ideor të prezentuar, planet urbane për këtë zonë dhe kushteve ekzistuese në parcelë, me qëllim të krijimit të zonës si tërësi urbane dhe funksionale për këtë qëllim.

Neni 3

Të gjitha procedurat që rrjedhin nga procesi i lejes ndërtimore që rezultojnë në përmbushjen e kushteve për kompletimin e dokumentacionit teknik si dhe taksat administrative janë obligim i komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Arsimit.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për ndërtimin e qerdhës së fëmijëve parashkollor multi-etnik në Lipjan 15Nr.610-24897 i datë 30.06.2014.

Pasi qështje tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 15,¹⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni